

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 22 DHJETOR 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 22. 12. 2003. GODINE

DHJETOR - DECEMBAR
2003



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin vjetor të Konsoliduar të Kosovës dhe përvetësimet për periudhën prej 1 janar deri me 31 dhjetor 2004.

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Друго разматрање Нацрта закона о Годишњем консолидованом буџету Косова и његовом распореду за период од 1 јануара до 31 децембра 2004 год.

AGENDA

1. Approval of the minutes of previous meeting,
2. Second reading of the Draft Law on the annual consolidated budget of Kosovo, and the appropriations of time from January 1 up to December 31, 2004.

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 22 DHJETOR 2003

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës – Prishtinë.

Seancën Plenare të Kuvendit të Kosovës, e kryesoi Akademik **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit.

Bashkëkryesuese **Nafije Gaš**, anëtare e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 11,10.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mendoj se mund të fillojmë.

Mirëseardhje deputetëve në Seancën e radhës. Mirëseardhje deputetëve - ministra.

Të enjten e kaluar është caktuar vetëm një pikë e rendit të ditës dhe lidhur me këtë, materialet ju janë shpërndarë me kohë.

Prandaj, hap Seancën plenare.

Urdhëroni. E ka fjalën profesor Sabri Hamiti, në emër të LDK.

SABRI HAMITI:

I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës, të nderuar kolegë deputetë,

Të gjithë i keni njoftimet që po organizohen dhe do të organizohen votime e zgjedhje për parlamentin e Serbisë në territorin e Kosovës. Kemi madje njoftime që kandidatë të zgjedhur për zgjedhjet në Serbi janë edhe disa anëtarë të Kuvendit të Kosovës, madje të Kryesisë së tij, si dhe anëtarë të Qeverisë.

Kuvendi i Kosovës, si organi më i lartë përfaqësues i këtij vendi, duhet të marrë qëndrim lidhur me këto zhvillime të panatyrshme dhe politikisht të dëmshme për Kosovën.

Më së pari UNMIK-u dhe OSBE-a në Kosovë duhet të lirohen nga politika dyfryshe - hipokrite dhe të tregojnë se nuk mund të ketë zgjedhje politike të Beogradit në Kosovë. Arsyetimet e tyre të mëhershme: që nuk do të pengojnë as nuk do të trimërojnë këto zgjedhje - tash janë të papranueshme, meqë dihet se zgjedhjet e tilla krijojnë tensione në Kosovë, sidomos tensione politike ndërmjet etnive dhe përpiqen të paragjykojnë në mënyrë tinzare statusin politik të Kosovës.

Në anën tjetër, anëtarët e këtij Kuvendi nuk mund e nuk duhet të jenë kandidatë për zgjedhjet në Serbi. Si mund të jetë një njeri në organet përfaqësuese të dy vendeve në të njëjtën kohë?!

Kuvendi i Kosovës, nëpërmjet një deklaratë sot e këtu duhet të marrë qëndrim për këtë problematikë. Kuvendi i Kosovës, pra, duhet të kërkojë që zgjedhjet politike të Serbisë të mos organizohen në Kosovë, meqë Kosova është momentalisht nën administrimin e OKB. Kuvendi i Kosovës duhet t'i shpallë këto zgjedhje të paqena e të papranueshme dhe jam i sigurt që në diskutimin e kësaj çështjeje në këtë seancë dhe në përfundimet do të kemi përkrahjen e artikuluar edhe më parë të grupeve tjera parlamentare. Ju falënderoj.